

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

e-buletini

no.07

korrik - dhjetor 2013




PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë
www.ruralnet.mk
email: info@ruralnet.mk

"Kosta Veselinov" 3a
1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503

Në këtë numër...

1. AKTIVITETE TË ORGANIZATËS ETNO BEBA NGA KUMANOVA 2
2. STUDIO E HAPUR: "MALI I KALTËR" NË ART POINT - GUMNO 3
FESTIMI I PIREUT I SHTATË PËR NDER TË JETËS SË PËRHERSHME TË VËLLEZËRVE LUBÇO DHE VLLADO CVETANOVSKI 4
3. BASHKËPUNIM MES QENDRËS QËNDRUESHMËRI DHE ARSIM TË AVANCUAR DHE DUNA VISION 6
4. FUSHATË E ORGANIZATËS "EKO LOGIK": NË PUNË ME BIÇIKLETË 7
AKTIVITETE TË ORGANIZATËS EKO LOGIK NË PERIUHDËN PREJ KORRIK DERI NËNTOR 2013 8
5. BASHKËPUNIM MES IZHAK DHE RZR TË RM 9
6. „ENERGJIA DIELLORE ELEKTRIKE DHE NGROHËSE PËR ULJEN E EMISIONEVE TË CO2 NGA ÇERDHJA“ 10
U MBAJT SEMINARI ME TEMË "PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT TË PUNËS SË NDËRMARRJEVE PUBLIKE KOMUNALE" 11
7. PROMOVIMI I KULTURËS DHE TRADITËS SË KRUSHEVËS 12
8. EKSPOZITË E HAPUR "KARPINO 2013" NË KUADËR TË KOLONISË SË 11-TË NDËRKOMBËTARE TË ARTIT 13
9. LIGJËRATË EDUKATIVE PËR KANCERIN E GJIRIT 14
10. KUVENDI VJETOR I RRJETIT PËR ZHVILLIM RURAL 15
11. PJSËMARRJE E RZR TË RM-SË NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJE EVROPIANE 16
12. PJSËMARRJA E RRJETIT PËR ZHVILLIM RURAL NË MANIFESTIMIN "VJELJA E MOLLËVE" 17
13. VIZITË STUDIMORE NË IZRAEL 18
14. VIZITË STUDIMORE NË ITALI 19
15. KARAVANI PËR NDRYSHIME KLIMATIKE NDIHMON KOMUNITETET RURALE TË ADAPTOHEN 20
16. RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË VIZITË STUDIMORE NË SHBA 21
17. FILLIMI I AKTIVITETEVE PËR PROMOVIM TË LEADER QASJES NË RAJONIN JUGLINDOR TË PLANIFIKIMIT NË RM 22
18. NDARJA E REZULTATEVE TË DERITANISHME DHE ARRITJE NGA PROJEKTI I USAID PËR ADAPTIMIN E BUJQËSISË NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE 23
19. PËRFSHIRJA E RZR NË PROGRAMIN E USAID PËR PËRMIRËSIM TË PUNËS SË ORGANIZATAVE - PPPO 24
20. KONFERENCË PËR BUJQËSI FAMILJARE NË BRUKSEL 25
21. PJSËMARRJA E RZR I RM-SË NË MBLEDHJEN E 28 TË KUVENDIT TË GRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS PËR ZHVILLIM RURAL I EVROPËS JUGLINDORE 26
22. U PUBLIKUA LIBRI NGA PREPARE 27
23. PJSËMARRJE TË RRJETIT PËR ZHVILLIM RURAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË PARLAMENTIN RURAL EVROPIAN TË PARË 28





Aktivitete të organizatës ETNO BEBA nga Kumanova



Organizata Etno Beba nga Kumanova, në gjashtë muajt e fundit në mënyrë aktive punon dhe merr pjesë në një numër të evenimenteve të drejtuara kah afirmimi dhe ruajtja e kulturës dhe traditës në Maqedoni.

Më 3 nëntor 2013 në Kumanovë, Etno Beba në bashkëpunim me një organizatë tjetër - anëtare të RZR, , organizuan një manifestim me titullin "tryeze e fshatit dhe sofa e qytetit". Qëllimi i evenimentit ishte të prezantohet jetesa në mjedisin fshatar dhe qytetar, duke

ruajtur zakonet, vlerat kulturore, tradicionale dhe vlerat tjera të rajonit të Kumanovës. Njëherë ishte promovuar edhe ushqimi i shëndetshëm dhe natyror i përgatitura nga rreth 16 grave të qytetit dhe fshatit, ndërsa ishin shprehur edhe mundësitë për zhvillim të turizmit alternativ, rural dhe eko.

Me mbështetje të Rrjetit për Zhvillim rural dhe në bashkëpunim me organizatën jo-qeveritare "Humanost", Etno Beba ka organizuar aheng të para vitit të ri në Kumanovë për fëmijët në zhvillim në Qendrën për Persona me të Meta.

Etno Beba ka marrë pjesë në më tepër evenimente dhe manifestime, mes të cilave edhe:

- Panairi Ballkanik "Artizanë-rojtarë të traditës" që u mbajt në Shkup prej 28-30 qershor 2013;
- DITA E PAULIT në Pehçevë prej 10-13 qershor 2013 ku kanë marrë pjesë bashkë me organizatën e grave nga Pehçeva;
- Ditët e Ilindenit në Manastir dhe Krushevë, ku ka marrë pjesë aktive në evenimentet e organizuar nga gratë artizane nga Manastiri;
- Manifestimi RAJONI I MALESHEVËS NË PËLLËMBË, që komuna e Berovës në mënyrë tradicionale e organizon me rastin e MËRISË SË SHENJTË në Sheshin në BEROVË ku Etno Beba është e pranishme vitin e nëntë me radhë;
- Ditë Evropiane të Trashëgimisë Kulturore, që këtë vit janë mbajtur prej 24-30 shtator në Prishtinë në Sheshin «Nënë Terezë», në organizim të Portës së Hapur dhe z-nja Bejtuzare Muharemi, ku Etno Beba për herën e nëntë kanë marrë pjesë si përfaqësues të vetë nga Maqedonia;
- Dita e Gruas Rurale, e organizuar më 15 tetor 2013 nga ana e FFRM-së.






Studio e hapur: “MALI I KALTËR” në ART POINT - GUMNO

10 vite rekrutim të ambasadorëve kulturor për Maqedoninë

Me fillim nga viti 2003, në qendrën ndërkombëtare artistike ART POINT - GUMNO kanë qëndruar dhe krijuar më tepër se 40 artistë të afirmuar nga gjithë bota që edhe sot e realizojnë synimin e qendrës - të veprojnë si ambasadorë kulturor për Maqedoninë.



kryer gjatë 10 viteve të fundit.

Vetë punësia ka zgjatuar 15 ditë, më saktë prej 2-15 shtator. Artistët kishin mundësi sërish të kthehen në inspirimet e tyre në Slloeshticë dhe Maqedoni në përgjithësi, por edhe të njoftohen mes vete dhe të diskutojnë për projekte të reja me karakter rajonal. Prioritet ishte dhënë projekteve që kanë për qëllim të vendosin në pah vlerat kulturore-artistike, historike dhe natyrore të Maqedonisë dhe trashëgimisë së saj të pasur hyjnore.

Vendosja e artistëve ishte organizuar në shtëpi private, në familje të fshatit që më shumë e pasuroi projektin në aspektin socio-ekonomik. Shqimit ishin të përgatitura nga anëtarë të qendrës, ndërsa prej kohe në kohë, vendoseshin specialitete tradicionale që i përfaqësonin dhe përgatiteshin nga mysafirët.

Veprat e krijuara gjatë kësaj

Me rastin e përvjetorit të 10-të nga themelimi i rezidencës ndërkombëtare artistike ART POINT - GUMNO, në shtator 2013, në qendrën ndërkombëtare të fshatit Slloeshticë ishte organizuar punëtori artistike në temën

“Mali i kaltër”. Në punëtorinë kanë marrë pjesë 10 mysafirë/artistë nga Britania e madhe, Gjermania, Danimarka, SHBA, Sllovakia, Hungaria dhe Çekia.

Punëtorisë në formë gare i paraprinte ekspozita “10 vite ART POINT - GUMNO”

që realizohej në kuadër të manifestimit Vera Kulturore e Manastirit 2013 - BitFest në galerinë MAGAZA në Manastir në periudhën prej 26 korrik deri më 1 gusht. Ishin ekspozuar mbi 50 veprat nga koleksioni ekzistues në qendrën ndërkombëtare si retrospektivë e punës së



punëtorie ishin tematike (Mali i kaltër) dhe në fund të punëtorisë, në të a.q. "Studio e hapur" që u zhvillua më 10 shtator, ishin ekspozuar në galerinë dhe hapësirën e hapur të qendrës.


Punëtorja ishte realizuar

në nivel të lartë profesional dhe ka arritur publicitet të madh, me mbështetje nga Ministria e Kulturës së RM-së, ndërsa falënderim të veçantë për mjetet financiare nga buxheti i tyre/privat i organizatorëve dhe puna e tyre e vyeshme vullnetare.





FESTIMI I PIREUT i shtatë për nder të jetës së përhershme të vëllezërve Lubço dhe Vllado Cvetanovski



СЛАВЕЊЕ НА ПИРЕЈОТ

28 август 2013 год.
Голема Богородица, с.Слоештица

Програма:

18:00	„Беседа за Петре М. Андреевски“ - Јордан Плевнеш (локација: Селски гробишта)
18:15	„Детето во светот“ - Документарен филм, премиера. Сценарио: Вlado и Љубе Цветановски. Режија: Гоце Цветановски (Локација: ОУ Браќа Миладиновци)
19:30	„Секојдневни надмудрувања“ - промоција на првото печатено дело на Љубе Б. Митрејчевски. Промотор: Добре Тодоровски (локација: Средсело)
20:00	„Песни за Македонија“ - промоција на стихозбирката на Дик Робертс. Промотор: Елизабета Баковска (локација: Средсело)
20:30	„Вечниот живот на Вlado Цветановски“ - повско сценски ораториум посветен на ликот и делото на Вlado Цветановски (локација: Средсело - Мостот Бела Река)
20:45	„Омаж за Вlado Цветановски“ - визуелен омаж за работата на Вlado Цветановски во полето на театарот и филмот (локација: Мостот Бела Река)

Поддржано од: Г-дин Љупчо Блажевски, Градоначалник на Општина Демир Хисар

Art Point Gumno & ENOH

Qendra ndërkombëtare për art dhe zhvillim të qëndrueshëm ART POINT GUMNO dhe shtëpia e produksionit ENOH, më 28 gusht 2013, në festën e Mërisë së Shenjtë, në fshatin Slloeshticë, për herën e shtatë organizon manifestimin multimedial “FESTIMI I PIREUT” që mbahet për nder të Petre M. Andreevski, shkrimtari që më thellë ka depërtuar për mirëqenien e popullit maqedonas.

Këtë vit, për shkak të vdekjes së hershme të një prej atit

hyjnor të këtij evenimenti - regjisor, profesori dhe dramaturgu Vllado Cvetanovski dhe vëllai i tij Lube Cvetanovski - shkrimtar i dalluar, skenarist, ciceron dhe profesor, qëllimi i organizatorëve ishte që në mënyrë simbolike të festojnë jetën e tyre të përhershme.

Pas këndimit për Petre M. Andreevski që në varrin e të madhit, këtë vit e mbajti Jordan Plevnesh, në shkollën në Slloeshticë, para premierës, ishte shfaqur filmi dokumentar “Fëmija në botë” në regji të Goce Cvetanovski.

Filmi është inspiruar nga teksti i autobiografisë “Fëmija brenda meje” i Lube Cvetanovski. Kujtimet e fëmijërisë në Slloeshticë dhe Demir Hisar të udhëtarit të madh botërore janë ilustruar në ciceronet e tij.


Jeta e përhershme e Vllado Cvetanovski është oratorium poetik skenar në të cilën kanë marrë pjesë aktorë/personazhe nga veprat e tij origjinale të skenës, ndërsa në urën Bella REka, ku Cvetanovski çdo verë akumulonte inspirime të reja, ishte projektuar homazh

virtual për punën e tij në fushën e teatrit dhe filmit.

Në kuadër të manifestimit, ishin promovuar edhe dy libra: përmbledhja e rrëfimeve popullore nga rajoni i Demir Hisarit me titull “Mençuritë e përditshme” të Lube B. Mitrejevski (edicion i autorit) dhe përmbledhja me vjersha “Vjersha për Maqedoninë” nga artisti amerikan Dik Roberts i cili prej vitit 2007 është banor i nderit në fshat (edicion i ART POINT - GUMNO, mbështetur nga Ministria e Kulturës së RMJ).

Manifestimi ishte mbështetur nga kryetari i komunës së Demir Hisarit, z. Lubço Bllazhevski, ESRA- Universiteti për Arte Audiovizuale dhe shtëpia e produksionit “Makedonska Krepot”.

Përgatiti: Irena Andreevska





Bashkëpunim mes Qendrës qëndrueshmëri dhe arsim të avancuar dhe DUNA VISION

Në nëntor të vitit 2012, Qendra për qëndrueshmëri dhe arsim të avancuar (<http://csae.mk>) nga Manastiri filloi bashkëpunimin me Duna Vision, organizatë joqeveritare që vepron në fushën e ekologjisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, për realizimin e aktiviteteve të ardhshme të përbashkëta.

Pjesë e këtyre aktiviteteve janë edhe organizimi i Forumit të parë Ballkanik për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe projekti afatgjatë Eko-Fshat.

Forumi i parë Ballkanik për Zhvillim të Qëndrueshëm do të organizohet në bashkëpunim me më shumë organizata lokale siç janë: Parku kombëtar "Pelister", Institucioni kombëtar Enti dhe Muzeu- Manastir dhe Ballkanika- Shkup. Forumi do të realizohet në qershor të vitit 2014 dhe do të siguron hapësirë për shfaqje të ideve të shumta, organizatave dhe individëve nga fusha e zhvillimit të qëndrueshëm.

Eko-Fshati është koncept i ri që Duna Vision vetëm më e ka realizuar në pjesë tjera të Evropës, kurse në Ballkanin Perëndimor e zgjodhën Manastirin si lokacion për Eko-



Fshat. Për këtë qëllim Duna Vision ka formuar fondacion dhe kërkon tokë të pazhvilluar – hapësirë si dhuratë, hua ose tokë me qira deri disa dhjetëra hektarë, në distancë prej dhjetëra kilometra prej Manastirit

nëpërmjet partnerit lokal – Qendrës për qëndrueshmëri dhe arsim të avancuar.

Eko-Fshati do të mundëson zhvillimin e teknologjive alternative të qëndrueshme siç janë burimet e rinovueshme të energjisë, bu-

jqësia organike, permakultura dhe do të paraqet një pikë ku studentët e studimeve pasdiplomike dhe të doktoraturës nga Bashkimi Evropian do të zhvillojnë hulumtime praktike në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm.



Fushatë e organizatës “EKO LOGIK”: NË PUNË ME BIÇIKLETË




Eko Logik“, organizatë që kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor, ka organizuar një ngjarje me të cilën tentoi drejtpërdrejt të tërheq vëmendjen e pjesëmarrësve në komunikacion, për të ndikuar për ngritjen e nënvetëdijes së qytetarëve, të cilët, siç thek-

sonin, çdo ditë gjithnjë e më tepër ju keqësohet shëndeti i tyre nga ajri i ndotur. Për momentin, aktivitetet tona dhe gjithë puna jonë është përqendruar në transport të qëndrueshëm, informacione dhe edukim në lidhje me atë temë, propozime dhe veprime për zbatimin e përdorimit më



masiv të biçikletave, ecjes në këmbë si dhe përdorimi i transportit publik, ndërsa i realizojmë nëpërmjet iniciativës sonë: «Programi për zvogëlimin e ndotjes së ajrit në Maqedoni», në të cilat janë inkomporuar edhe projektet: «STOP për parkim në rrugët për biçikleta dhe këmbësorë»; «Në punë me



biçikletë» dhe «Eja në shkollë në mënyrë ekologjike», deklaroi organizata. „Eko Logik“ thekson që ndotja e rritur për madje edhe pesëmbëdhjetë herë i tejkalon gjitha kufijtë për jetesë dhe veprimtari normale, dhe me atë edhe e drejta për ajër të pastër është e shkelur tërësisht.





Aktivitete të organizatës EKO LOGIK në periudhën prej korrik deri nëntor 2013

Eko Logik është organizatë joqeveritare që është dedikuar ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor, promovim të praktikave bashkëkohore ekologjike si dhe ndjekjen dhe avancimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në periudhën prej korrik deri nëntor 2013, organizata vazhdoi me aktivitetet nga "Programi për uljen e ndotjes së ajrit në Maqedoni" (krijuar në shkurt 2013). Ky program i shumëfishtë përbëhet nga 15 projekte më të vogla, të cilat në mënyra të ndryshme kontribuojnë në uljen e ndotjes së ajrit. Prej këtyre, është filluar me realizimin e projekteve: "Me biçikletë në punë"

- fushata për STOP për parkim në rrugët për biçikleta dhe këmbësorë, "Eko rrëfime" - rrëfime të pavarura (gazetari kërkimore), "Bëhu jeshil dhe eja në shkollë në mënyrë ekologjike" projekt për ngritjen e vetëdijes tek më të rinjtë (të shkollave fillore).

Më tutje, kanë organizuar punëtori kreative në shkollat fillore për të promovuar konceptin 3R - ripërdorim/reduktim/riciklim. Si pjesë e këtij projekti, ishin mbështetur rreth 30 punëtori në të cilat nga gjëra të ndryshme të përdorura ishin krijuar gjëra të reja me funksion të ndryshme nga më para.

Ishte organizuar punëtori



me mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave fillore në komunën Karposh në temën: ndotja e ajrit dhe transporti i qëndrueshëm (në bashkëlidhje fotografi).

STOP për shkatërrimin e Vodnos - kyçje në iniciativën masive për ndalimin e aktiviteteve që përgjithmonë shkatërrohen mushkëritë në Shkup - malin Vodno.



СТОП за уништувањето на ВОДНО!



Bashkëpunim mes IZHK dhe RZR të RM

www.irz.org.mk



Shoqata Institut për zhvillim të komunitetit (IZHK) – Tetovë është anëtare e RZR prej vitit 2011, në pajtim me aktivitetet strategjike dhe programime.

Në periudhën 2012-2013, IZHK në bashkëpunim me anëtarët tjerë organizativ dhe zyrën qendrore të RZR, punon në përf forcimin e kapaciteteve të veta me qëllim që në periudhën ardhshme të zhvillimit të siguron ndihmë dhe përkrahje në komunitet dhe palët e interesuara për zhvillim rural.

Anëtarësimi i IZHK në RZR ndihmon pozicionimin e saj si një prej organizatave aktive dhe të njohura për përpjekje në zhvillimin rural të rajonit veriperëndimor të Republikës së Maqedonisë, e cila siguron përkrahje të vazhdueshme atyre që ju nevojitet ndihmë për zbatimin e aktiviteteve të veta, qoftë ato institucione publike, organizata joformale, njësi të vetëqeverisjes lokale dhe tjera.

Në 2 vitet e kaluara, IZHK ka zbatuar shkollën e RZR, ku ka siguruar mundësi që

të papunësuarit e rinj nga vendet rurale të rajonit të Tetovës të marrin pjesë dhe

të risin njohuritë e tyre, dhe pastaj me përkrahje të IZHK të formojnë ndërmarrje sociale në mjediset rurale, me qëllim që t'u përgjigjen sfidave në nivel lokal.

Ndihmë e madhe për të punësuarit në IZHK ishte mundësia për komunikim të drejtpërdrejtë me të punësuarit nga zyra qendrore, ku kemi fituar informata cilësore mbi aktivitetet në zhvillim, ngjarjet dhe transferimin e njohurive, që shumë ka ndihmuar punën e IZHK në periudhën e kaluar.

Gjatë vitit 2014 IZHK parashihet rritje të investimeve të resurseve të veta në projekte konkrete, që do të zbatohen në bashkëpunim me komunitat nga rajonet rurale.





„Energjia diellore elektrike dhe ngrohëse për uljen e emisioneve të CO2 nga çerdhja“

Koçan, 17.12.2013



Në periudhën prej janar deri dhjetor 2014 në komunën Koçan do të realizohet projekti “Energjia diellore elektrike dhe ngrohëse për uljen e emisioneve të CO2 nga çerdhja”. Bartës i projektit është Shoqata për mbështetjen e zhvillimit ekonomik - Grupi Lokal i Aksionit -Koçan. Shuma e plotë e projektit është 46.420 USD dhe është financuar nga Programi për grante të vogla (PGV) të Fondit Global Ekologjik (FGE) në shumë prej 22.670 USD dhe kofinancuar nga komuna e Koçanit me 21.770 USD. Çerdhja për fëmijë “Pavlina Veljanova”-Koçan merr pjesë me mjete financiare prej 1.980 USD.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të zvogëlohen emisionit e CO2 me kursimin e energjisë elektrike dhe mjeteve financiare.

Ky qëllim do të arrihet me atë që në pjesën 1 të çerdhës për fëmijë do të vendosen kolektorë hibrid solar që në kohën e njëjtë do të prodhojnë energji elektrike dhe do të ngrohin ujë. Pjesa 1 është zgjedhur sepse në këtë pjesë gjendet kuzhina kryesore në të cilën përgatitet ushqimi për gjitha 4 pjesët e çerdhës për fëmijë, ndërsa ajo do të thotë që shpenzohet sasi më e madhe e ujit të ngrohtë, si për përgatitjen e ushqimit, ashtu edhe për larjen e enëve. Uji i ngrohtë, që për momentin ngrohet me energji elektrike, përdoret



The GEF
Small Grants
Programme



Komuna Koçan ZPEP - Grupi Lokal i Aksionit-Koçan

edhe për ngrohjen e ujit në bojlerët në çerdhët që përdoret për larjen e fëmijëve. Një pjesë e energjisë elektrike të fituar do të përdoret edhe për ndriçimin e hapësirave.

Si pjesë e projektit, gjithashtu, planifikohen aktivitete për formimin dhe zhvillimin e vetëdijes për rëndësinë e BRE (burimeve të ripërtërishtme të energjisë) tek popullata më e re, gjegjësisht për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeç nga grupet e mëdha në çerdhën me anë të zhvillimit të “orës edukative” për të cilat do të përgatiten ngjyrosje në temën BRE, ndërsa do të realizohet edhe garë në vizatim në temën “Duell” në të cilën vizatimi i vendit të parë do të sugjerohet të bëhet logo e çerdhës. Pritet ulje prej 5 tonelatave CO2 në vit dhe kursim prej 94.000 MKD në vit. Mjetet e kursyera do të investohen në aktivitete vijuese ekologjike.

Me anë të mbulimit mediatik të projektit dhe me ma-

terialet edukative që do të përgatiten gjatë realizimit të projektit do të ndikohet edhe mbi ngritjen e vetëdijes publike tek qytetarët e komunës së Koçanit dhe komunave fqinje.

Informacione plotësuese për projektin mund të sigurohen tek koordinatori i projektit Marija Georgieva në telefonin: 078/313-210 ose në postë elektronike: lagkocani@gmail.com.

Më tepër informacione për GEF MPG mund të gjenden në <http://gefsgpmacedonia.org.mk/> dhe në <https://sgp.undp.org/>.





U mbajt seminari me temë “PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT TË PUNËS SË NDËRMARRJEVE PUBLIKE KOMUNALE”

S hoqata për mbështetjen e zhvillimit ekonomik - Grupi Lokal i Aksionit Koçani më 18 nëntor 2013 në Dojran zhvilloi një seminar në temën “Përmirësimi i efikasitetit në punën e Ndërmarrjeve Publike Komunale”. Seminari ishte organizuar në bashkëpunim të përbashkët të CmC Eko-kon-Shkup, Vatako-Shkup, Tehnoskop-Shkup, Megasoft - Manastir, Fortuna Grup-Shkup, EKO PAK Hit Koçan



dhe Akua Sejv-Shkup. Rreth 70 përfaqësues të NPK në Republikën e Maqedonisë nga strukturat drejtuese kanë marrë pjesë në këtë ngjarje. Ishin organizuar shtatë prezantime për shërbime dhe produkte që ofrojnë firmat-sponsorët.

Njëherë seminari ishte mundësi e shkëlqyeshme për shkëmbim të përvojave të punës mes NPK të qyteteve të ndryshme në RM dhe vendosja e relacioneve partnere dhe afariste mes përfaqësuesve të NPK dhe kompanive.





Promovimi i KULTURËS DHE TRADITËS SË KRUSHEVËS



naire, ku me ekspozimin e punimeve të tyre dhe me vendosjen e bashkëpunimit me organizata vendore dhe ndërkombëtare, e promovojnë kulturën e Krushevës.



Në Krushevë, qyteti i shtrirë në zemrën e Maqedonisë, në secilën shtëpi dhe rrugë flasin për të kaluarën e guximshme historike dhe kulturore, është themeluar organizata e grave "Cvet". Gratë pu-



nëtore të kësaj organizate, gjithë dashurinë e tyre, krijimtarinë dhe shkathtësitë i kanë shprehur në artizanatet e tyre, njëherë edhe duke transferuar veçoritë dhe aftësitë në brezat e rinj. Ata në mënyrë aktive punojnë në ruajtjen dhe afirmimin e kulturës dhe traditës së Krushevës, me anë të përpunimit të artizanëve dhe përgatitjes së specialiteteve tradicionale të Krushevës. Ata rregullisht marrin pjesë në ngjarjes e organizuar në qytetin e tyre, si dhe në pa-





Ekspozitë e hapur “KARPINO 2013” në kuadër të kolonisë së 11-të ndërkombëtare të artit



Me rastin e festës 11 nëntori, dita e çlirimit të qytetit, në NUCK «Trajko Prokopiev» u hap ekspozita «Karpino 2013» në kuadër të kolonisë së 11-të ndërkombëtare të artit.

Ekspozita ishte dedikuar aktorit të vdekur, udhëheqësit artistik, artistit dhe anëtarit

të Shoqatës Multimediale «Karpino», Dragisha Dimitrievski Shipe.

Gjatë kolonisë kishte mysafirë nga gjithë Maqedonia, Bullgaria, Serbia dhe Belgjika. Qytetarët e Kumanovës kishin mundësi të shohin 38 vepra të përpunuar nga 16 artistë - piktorë, skulptor dhe grafik, që kanë

krijuar në periudhën prej 7 deri 14 gusht në restorantin «Gracia» në Kumanovë. Me atë, kolonia e 11-të ndërkombëtare artistike që ishte karakterizuar si një prej kolonive më produktive deri më tani përfundoi. Autorët kishin mundësi të shoqërohen, krijojnë dhe argëtohen duke u nënshkruar në shishe të kufizuara speciale të verës si përkujtim, duke lëshuar balone me ajër

të ngrohtë në orët e vona të natës si mesazh.

Në hapjen e kolonisë ishte promovuar bista e Dragisha Dimitrievski Shipe. Qendra Multimediale Karpino, organizoi vizita për pjesëmarrësit në manastirin Karpino, observatorin Kokino, manastirin Shën Gjeorgji, Staro Nagoricanë, kishën Shën Nikolla në Kumanovë dhe vende tjera.





Ligjëratë edukative për KANCERIN E GJIRIT



Më 11 dhjetor 2013, në f. Zhitoshe, komuna e Dollneni, në ambulancën e f. Zhitoshe, shoqata "BORKA" në bashkëpunim me Shoqatën SZHZH-Zhitoshe, ka mbajtur ligjëratë edukative për kancerin e gjirit.

Në ngjarjen ligjëruan :

- Z-nja Biba Dodeva-Kryetare e BORKA, "Kanceri i gjirit mund të shërohet"
- Z-nja Sabaheta Mersimi - Shoqata SZHZH-Zhitoshe
- Dr. Elizabeta Babushku, spec. radiodiagnostikante, REMEDIKA Shkup, "Procedura në diagnostifikimin bashkëkohor të kancerit në gji"
- Z-nja Zhaklina Jovanovska, Medikus Help Shkup, "Limfedema"





Kuvendi vjetor i Rrjetit për Zhvillim Rural

Më 22.11.2013, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka zhvilluar Kuvendin e tretë vjetor në të cilën kanë marrë pjesë 44 përfaqësues të organizatave – anëtare të RZR-së.

Kuvendin vjetor e hapi kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural i RM-së, z. Petar Gjorgievski, duke ju uruar mirëseardhje të gjithë anëtarëve të pranishëm të RZR-së. Menjëherë pas fjalimit të tij, z-nja Vesela Llambev-ska Domazetova, kryetare e këshillit drejtues të RZR-së së RM-së, prezantoi aktivitetet e realizuara të Rrjetit për

Zhvillim Rural gjatë periudhës së vitit 2012/2013. Me këtë rast, prezantim kishte edhe z. Vasko Haxhievski në temën “Ndikimi i ndryshimeve klimatike në infrastruktura të ndryshme”. Ai morri mjaft interes dhe vëmendje nga të pranishmit duke sqaruar karakteristikat e llojeve të ndryshme të infrastrukturave, ndikimet potenciale nga ndryshimet klimatike mbi këto si dhe mundësitë për përshtatje. Aleksandra Todorovska nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, ju drejtuar drejtpërdrejtë anëtarëve, duke ngritur pyetje lidhur me komunikimin dhe shkëmbimin e informa-



cioneve me organizatat anëtare. Ajo shprehi mirëseardhje zyrtare të tre organizatave të reja që u bënë pjesë e RZR-së gjatë vitit 2013 dhe i informoi për përgatitjen e numrit të ri të buletinit elektronik.

Pas përfundimit të fjalimeve nga gjithë folësit, ishte hapur diskutim, gjatë së cilës kishte propozime konstruktiv nga ana e anëtarëve.

Petar Gjorgievski dërgoi apel drejt gjithë organizatave për aktivitet më të madh dhe ndërmarrje të iniciativave. Idetë duhet të rrjedhin nga vetë anëtarët dhe në mjediset e duhura, ndërsa Rrjeti do të bëjë zbatimin e tyre në nivelin më të lartë,

në përputhje me bottom-up qasjen, që paraqet një bazë për funksionim.

Pas përfundimit të kuvendit vjetor, ishte organizuar një aktivitet për rrjetëzimin e organizatave anëtare të RZR-së që të njoftohen më mirë dhe të realizojnë mundësi për bashkëpunim, me anë të prezantimit të shoqatave të tyre dhe aktiviteve në stendat e vendosura paraprakisht në sallën.





Pjesëmarrje e RZR të RM-së në Komisionin për Çështje Evropiane

Kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë, Petar Gjorgjievski ka marrë pjesë në vazhdimin e gjashtë të seancës së 42-të të Komisionit për Çështje Evropiane, dedikuar debatit mbikëqyrës në temën: “Përdorimi i fondeve të Instrumentit për Ndihmë Para-Aderimit IPA” në Republikën e Maqedonisë, që ishte zhvilluar më 29 tetor 2013.

Në këtë seancë kanë dëshmuar gjashtë dëshmitarë, mes të cilëve edhe Ministri për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, z. Abdulaqim Ademi, Ministri dhe Zëvendës Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë të Ujit të Republikës së Maqedonisë, z. Lubčo Dimovski dhe z. Zoran Konjanovski.

Në lidhje me komponentin V, e cila ka të bëjë me zhvillimin rural në Republikën e Maqedonisë, në pyetjet e deputetëve u përgjigjen edhe udhëheqësi i Trupit për Udhëheqje me IPARD Programin, z-nja Margarita Deleva, kryetari i rrjetit për

zhvillim rural i Republikës së Maqedonisë, z. Petar Gjorgjievski si dhe i Federatës së Fermerëve, z. Andrija Sekullovski.

Gjatë dëshmimeve të tyre, të ftuarit e pranishëm informuan për përvojat gjatë përdorimit të të hollave evropiane dhe informuan për ndryshimet në lidhje me përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave për marrjen e mjeteve financiare nëpërmjet këtij instrumenti.

Deputetët Antonio Milloshoski, Hajrulla Misini, Pançe Orcev, Goran Sugarevski, Vlladanka Aviroviq, Lençe Nikollovska, Dëshira Imeri, Pançe Dameski, Savo Maračkov, Stanka Anastasovska dhe Hristina Runçeva parashtruan më tepër pyetje kryesisht lidhur me mundësitë që IPARD mjetet të jenë më të kapshme për qytetarët, sepse përdorimi i këtyre mjeteve është i vogël dhe ku gjenden dobësitë e përdorimit të dobët si dhe pyetje tjera. (burim: www.sobranie.mk)





Pjesëmarrja e Rrjetit për Zhvillim Rural në manifestimin “VJELJA E MOLLËVE”

Gjatë periudhës prej 27 deri 29 shtator, komuna e Resnjës për herën e 13-të ka organizuar manifestimin “vjelja e mollëve” që tradicionalisht zhvillohen për nder të mollës dhe fillimit të vjeljes së mollës. Manifestimi ka përfshirë shumë aktivitete nga fusha e bujqësisë, kulturës, turizmit, artit dhe sportit. Ky manifestim madhor ekonomik-kulturores është e ndërlidhur me kremtimin e festës së madhe ortodokse-krishtere Dita e

Krishtit dhe njëherë paraqet edhe fillimin e vjeljes së mollës në Prespë.

Rrjeti për Zhvillim rural i Republikës së Maqedonisë ka marrë pjesë në eventin e këtij viti “Vjelja e mollëve 2013” duke ekspozuar materiale promotiv më 28 shtator, ditën që ishte dedikuar turizmit. Në stendën e Rrjetit ishin ftuar anëtarët aktive të këtij rajoni të cilën kanë dëshiruar të prezantojnë aktivitetet që zhvillojnë në kuadër të organizatave të tyre.





Vizitë studimore në Izrael



Pas zbatimit nismëtar të aktiviteteve për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike në kopshte demonstrative, bodrume vere dhe ferma për perime në kuadër të projektit të USAID-it për Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike në Bujqësi, vazhdimisht ishte dhënë ndihmë teknike për fermerët pjesëmarrës për aplikimin e drejtë të mesave specifike adaptive nga ana e ekspertëve teknik. Ata monitoruan reagimet e hershme dhe efektet preliminare nga përdorimi i këtyre praktikave. Megjithatë, për të mundësuar zbatim të më-

tutjeshëm me sukses të këtyre praktikave të reja dhe mundësisht të vëzhgohen masat e reja aplikative për masat adaptive për ndryshimet klimatike, ishte paraqitur nevoja të mundësojmë fermerëve pjesëmarrës dhe ekspertëve teknik të shijojnë eksperiencë të dorës së parë nga rastet paraprake të suksesshme.

Për atë qëllim, projekti vendosi të organizojë një vizitë studimore për fermerët pjesëmarrës, këshilltarët e ANZHB-së dhe ekspertët teknik për t'i ekspozuar në eksperiencë ndërkombëtare e cila do të mundësojë që të mësohet, shkëmbehen

eksperienca dhe të përfitohen me detaje lidhur me themelimin dhe funksionimin e praktikave të suksesshme adaptive ndaj ndryshimeve klimatike. Gjatë periudhës prej 14 korrik deri më 19 korrik, dymbëdhjetë pjesëmarrës kishin mundësinë të vizitojnë Izraelin që konsiderohet si një vend me eksperiencë të avancuar në praktika aplika-

tive për ndryshime klimatike. Fermerët pjesëmarrës në projektin, këshilltarët e ANZHB-së dhe ekspertët teknik ishin njoftuar me prodhimtarinë intensive të perimeve dhe rrushit, prodhimtari të farave të kulturave perimore, kërkime të aplikuara në kultura hortikulturore dhe teknologji të ndryshme aplikative bujqësore.





Vizitë studimore në Itali



Aktivitetet e projektit të USAID-it për Adaptimin e Ndryshimeve Klimatike në Bujqësi janë të dizajnuar në bazë të eksperiencave pozitive të praktikave ndërkombëtare për adaptimin e prodhimit në bujqësi ndaj ndryshimeve

ve klimatike, të përshtatur në nevojat tona specifike në teren dhe sipas rrethanave klimatike. Megjithatë, mbetet i vërtetë fakti që eksperiencia e drejtpërdrejtë dhe, përfundimisht, ajo eksperiencë e përfutur nuk mjafton. Të njëjtën mund të themi edhe për çështjet e

drejtuara nga institucionet publike që kanë lidhje me ndryshimet klimatike, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së ujit që është njëra prej tyre.

Për të zhvilluar kapacitetet brenda shtetit në lidhje me temën e praktikave të ndryshimeve klimatike, projekti ka investuar në një vizitë studimore për menaxhmentin e projektit, këshilltarët teknik për praktika adaptive dhe përfaqësues relevant nga MBPEU-së. Vizita studimore ishte organizuar në Itali në periudhën prej 14 deri 20 korrik. Në kuadër të vizitës studimore ishin organizuar takime me krijuesit e politikave për iniciativa dhe politika në fushën e ndryshimeve klimatike në bujqësi,

specialistë për ndryshime klimatike dhe autoritete rajonale përgjegjëse për zbatimin e politikave rajonale për ndryshime klimatike në bujqësi, si dhe vizita të fermave që kanë miratuar masat për të luftuar ndryshimet klimatike.

Pjesëmarrësit kishin mundësinë të vëzhgojnë eksperiencën evropiane gjatë ofrimit të përgjigjeve adekuate adaptive ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi përveç krijimit të politikave dhe zhvillimit të dokumenteve strategjike mbi ndryshimet klimatike, aksione konkrete/masa për adaptime ndaj ndryshimeve klimatike të ndërmarra nga Ministrinë relevante, etj.





Karavani për Ndryshime Klimatike ndihmon komunitetet rurale të adaptohen



Nikollës, Zoran Tasev dhe drejtori i projektit të USAID-it për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, Petar Gjorgievski.

„Jo shumë vonë, Maqedonia është nën ndikimin e një klime më të ngrohtë dhe më të thatë, ndërsa me atë gjithnjë më tepër krijohen valë më të ngrohta, thatësira, vërshime dhe breshër. Si fermerë, më së miri e kup-toni domethënien e kësaj. Juve drejtpërdrejtë i përjetoni pasojat e ndryshimeve klimatike”, tha drejtori i misionit të USAID-it, Xhejms Stejn. “Ne dëshirojmë të zvogëlojmë efektet negative nga ndryshimet klimatike mbi bujqësinë me anë të zhvillimit dhe shkëmbimit të teknologjive të gatshme për adaptim ndaj ndryshimeve



Me evenimentin në Sveti Nikollë më 26 shtator, Karavani për Ndryshime Klimatike, organizuar nga projekti i USAID-it për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, e përfundoi fushatën vjeshtore me të fundit prej gjithsej katër vizitave nëpër vendin. Me sjelljen e ekspertëve për ndryshime klimatike në mjediset rurale, Karavani për Ndryshime Klimatike i edukon fermerët individual dhe komunitetet e tyre në lidhje me efektet e pritura nga ndryshimet klimatike. Nëpërmjet seancave të pyetjeve të hapura dhe përgjigjeve, ekspertët do të diskutojnë për probleme të caktuara me të cilat përballohen fermerët, do të shkëmbejnë strategji për

adaptimin ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike dhe do të theksojnë rëndësinë nga përgjigje proaktive në nivel të komunitetit. Fjalime kishin edhe Ministri i Bujqësisë, Lubço Dimovski, drejtori i misionit të USAID-it në Maqedoni, Xhejms Stejn, kryetari i komunës së Sveti



klimatike, lidhur me nevojat e fermerëve individual.“

Për të zvogëluar efektet negative nga ndryshimet klimatike në sektorin bujqësor në Maqedoni, projekti punon me fermerë individual dhe komunitetet e tyre për zhvillimin dhe diseminimin e teknikave të gatshme dhe praktikave për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, zbaton fushata publike gjithëpërfshirëse dhe ndihmon për ngritjen e kapaciteteve të fermerëve individual.

Përveç Sveti Nikollë, gjatë muajit shtator, Karavani vizitoi edhe tre lokacione tjera: Vallandovë, më 18 shtator, Resnjë, më 21 shtator dhe Krivogashtani, më 25 shtator.



Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë në vizitë studimore në SHBA



Zëvendës drejtori i projektit të USAID-it për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, Vesela Llambevaska Domazetova, bashkë me përfaqësuesin e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të ujit, Lidija Çadikovska, kanë marrë pjesë në programin për vizita ndërkombëtare të udhëheqësve, me titullin

“Përshtatshmëria ndaj ndryshimeve klimatike”, e sponsoruar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, ndërsa e administruar nga organizata joqeveritare Mësimi Botëror.

Në kuadër të programit që ishte organizuar në periudhën prej 1 deri 11 dhjetor 2013, ishin realizuar disa takime me individë dhe përfaqësues të organizatave

nga SHBA-të, me qëllim të mundohet përfaqësuese të sektorit joqeveritar, autoriteteve kombëtare dhe lokale në Maqedoni të njoftohen me teknologjitë dhe qasjet e reja ndaj ndryshimeve klimatike në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujit, si dhe efikasitetit energjetik.

Departamenti i Shtetit, si qëllime specifike të projektit i theksoi: kërkimi i bashkëpunimit mes niveleve federale, shtetërore dhe lokale të pushteteve dhe roli i tyre në ndryshimet klimatike; analizimi i partneriteteve publike-private që punojnë në fushën e ndryshimeve klimatike; analiza e teknologjive të reja dhe strategjive në kuadër të ndryshimeve klimatike dhe mjedisit jetësor.



Fillimi i aktiviteteve për promovim të LEADER qasjes në rajonin juglindor të planifikimit në RM

Në kuadër të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka parashikuar realizimin e aktiviteteve lidhur me promovimin e LEADER qasjes së BE-së në komuna të rajonit juglindor të planifikimit në të cilat ndikimi i ndryshimeve klimatike pasqyrohet negativisht në jetën e përgjithshme të amvisërive rurale. Me afirmimin e LEADER qasjes së BE-së në mjediset rurale, RZR synon zhvillimin e kapaciteteve të gjitha palëve të interesuara në mjediset rurale me çfarë do të përmirësohet njohuria e tyre për planifikim participativ në proceset e vendimarrjes me rëndësi të madhe për bashkësinë. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, RZR-ja do të mbështet krijimin e një entiteti, Grupi Lokal i



Aksionit në formë të partneritetit privat-publik duke përfshirë partnerë të sektorit publik, privat dhe qytetar dhe duke mbuluar interesat e palëve të ndryshme të interesuara nga 4 komuna të këtij rajoni (Strumicë, Vasi-

levë, Bosillovë dhe Novo Sellë). Grupi do të ketë për qëllim të prezantojë interesat e palëve të ndryshme të interesuara që ekzistojnë dhe punojnë në territorin rural të komunave. Qëllimi i grupit do të jetë të zhvillojë një dokument strategjik për zhvillim lokal që do të mbështet dhe bashkojë iniciativat dhe aksionet lokale.

Për realizimin e aktiviteteve të tilla që në mënyrë të dukshme do të kontribuojë në përmirësimin e praktikave të qëndrueshme të mjedisve rurale në Maqedoni, më

13 dhjetor 2013 në Strumicë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka firmosur Memorandum për Bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Rajonit Juglindor të Planifikimit. Në ditën e njëjtë ishte zhvilluar punëtori, në cilën ishin ftuar gjitha dhjetë komunat e këtij rajoni, me qëllim të njoftohen më mirë me LEADER qasjen si metodë për nxitjen dhe zbatimin e zhvillimit lokal në mjediset rurale, rëndësia e saj si IPARD masë e ardhshme, si dhe të prezantohen aktivitetet e planifikuara.





Ndarja e rezultateve të deritanishme dhe arritje nga projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike

Rrjeti për Zhvillim rural ka organizuar dy punëtori, më 13 dhjetor në Rosoman dhe 20 dhjetor në Gjevgjeli, me qëllim të ndajë përvojat dhe rezultatet e praktikave adaptive bujqësore, të zbatuara dhe testuar në periudhën prej fillimit të zbatimit të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike në prill 2012 deri më sot.

Fermerët e pranishëm nga rrethina e Rosomanit dhe Gjevgjelisë kanë pasur mundësi të njoftohen me teknikat dhe masat e ndryshme për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, të cilat ishin demonstruar dhe testuar në vreshtari, kop-

shtari dhe pemëtari. Përveç rezultateve dhe arritjeve nga masat e zbatuara adaptive, ekspertët prezantuan monitorimin njëvjeçar të proceseve erozive, si dhe përfitimet nga zbatimi i masave adaptive për kursimin e ujit në prodhimtarinë bujqësore.

Në fund të punëtorisë kishte diskutim të hapur, ku fermerët kanë mundur të shkëmbejnë problemet që paraqiten gjatë punës së tyre bujqësore dhe të marrin këshilla të dobishme nga ana e ekspertëve, si dhe mënyrën si të përballohen me efektet e ndryshimeve klimatike dhe çfarë masa adaptive të prezantohen për të mbrojtur kulturat në pemëtari, kopsh-tari dhe vreshtari.





Përfshirja e RZR në Programin e USAID për përmirësim të punës së organizatave – PPPO



Rrjeti për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë u zgjodh si një prej pesë organizatave që do të fitojnë përkrahjen e Programit të USAID për përmirësim të punës së organizatave (PPPO) në dy vitet e ardhshme. Për këtë qëllim, u nënshkrua edhe memorandum i mirëkuptimit mes RZR dhe programit të përmendur të USAID, më 18 nëntor të vitit 2013, në zyrat e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara.

RZR do të përfshihet drejtpërdrejtë në zhvillimin e gjithë periudhës programime, prej zbatimit të vlerësimit të gjendjes së organizatës deri në krijim dhe zbatim të intervenimeve të organizatës, me qëllim që

aktivitetet e planifikuara me PPPO për rritje të kapacitetit të RZR të japin efektin e dëshiruar për organizatën. USAID ka angazhuar kompaninë konsulente DETRA Centar për zbatimin e PPPO. Kjo kompani konsulente ka metodologji të posaçme konsulente, të bazuar në qasjet botërore pjesëmarrëse më bashkëkohore, por adaptuar ndaj specifikave tona dhe ndaj qasjes pjesëmarrëse të USAID për përfundimin e kapaciteteve organizative dhe njerëzore. Aktivitetet për përmirësimin e kapaciteteve organizative dhe realizim fillojnë me diagnozën përkatëse për gjendjen e organizatave, sikur edhe tek shumica e metodologjive tjera konsulente, dhe si-

pas metodologjisë të DETRA Centar. Ky aktivitet fillestar i diagnostifikimit u zbatua në një punëtori kreative treditëshe, emëruar si Holignoza (diagnoza gjithëpërfshirëse organizative), e cila u zhvillua 4-6 dhjetor në Manastir, ku morën pjesë përfaqësuesit e organizatave –anëtar të RZR. Në dhjetor u organizuan

4 takime me fokus grupe, të përbëra prej të gjithë anëtarëve të RZR, të ndara përkatësisht në 4 rajone, që më shumë kanë ndihmuar në përcaktimin e gjendjes së Rrjetit, si dhe mundësitë dhe kushtet për përmirësim të mëtutjeshëm të punës dhe qëndrueshmëri afatgjate.





Konferencë për bujqësi familjare në Bruksel



Gjatë seancës së 60-të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, viti 2014 ishte emëruar si Viti Ndërkombëtar i Bujqësisë Familjare. Në udhëheqjen e Organizatës për Ushqim dhe Bujqësi, ka rolin e ngritjes së profilit të bujqësisë familjare duke e përqendruar vëmendjen botërore në rolin e saj për zbutjen e urisë dhe varfërisë, ofrimin e sigurisë së ushqimit dhe përmirësimit të amvisërive, duke mbrojtur mjedisin jetësor dhe llojlojshmërinë biologjike.

Si rezultat i kontekstit të deklarates së OKB-së për vitin 2014 si Viti Ndërkombëtar i Bujqësisë Familjare, dhe në pajtim me kontribu-

tet nga konsultimi me anë të internetit që ishte zhvilluar më 02.08.2013 dhe 11.10.2013, ishte zhvilluar një konferencë evropiane me titullin "Bujqësia familjare: një dialog drejt një bujqësie më të qëndrueshme dhe afatgjatë në Evropë dhe në botë" e organizuar nga Komisioni i BE-së më 29 nëntor 2013 në Bruksel.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, si agent mjaft aktiv i bashkësive rurale, kishte përfaqësuesin, Marija Trpevska, të pranishëm në konferencën. Konferenca kishte përmasa mjaft të mëdha. Më tepër se 400 pjesëmarrës, disa prej personave më të njohur dhe më të spikatur të politikave bujqësore në Evropë, ishin mbledhur për të diskutuar

mbi rolin rëndësishëm të bujqësisë familjare, sfidat kryesore dhe prioritetet për të ardhmen, si dhe identifikimin e mjeteve më efektive për të mbështetur bujqësinë familjare.

Disa prej folësve kryesor të konferencës ishin z-nja Loreta Dormal Marino, zëvendës drejtoreshë e përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – Komisioni Evropian, z. Dacian Cioloș, Komisar i BE-së për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Carlo Petrini, presidenti i organizatës Lëvizja Ndërkombëtare e Ushqimit të Ngadaltë, prezantimi i të cilit ishte uruar me një ovacion të gjatë nga të pranishmit në konferencën. Përveç nikoqirëve, në konferencën ishin ftuar edhe folës emi-

nent nga jashtë Evropë, të cilët kishin kontribut mbi rezultatet përfundimtare. Gjatë konferencës, ishin zhvilluar edhe tre punëtori paralele duke mbuluar temat:

- Punëtori 1: Praktika më të mira në bujqësinë familjare
- Punëtori 3: Modelet organizative për të përforcuar fermat familjare
- Punëtori 2: Qasje në teknologji dhe kërkim

Konferenca përfundoi me një Panel të Nivelit të Lartë gjatë së cilës edhe ishin arritur rezultatet më të mëdha duke shkëmbyer mendimet mbi temën e bujqësisë familjare nga gjithë pjesëmarrësit.

Përveç kësaj, rezultatet e konferencës do të merren parasysh edhe gjatë Konferencës Rajonale Evropiane (ERC) të FAO-s, e caktuar për 1-4 prill 2014 në Bukuresht, Rumani dhe gjitha zhvillimeve tjera që do të organizohen gjatë vitit 2014.





Pjesëmarrja e RZR i RM-së në mbledhjen e 28 të Kuvendit të Grupit të Përherëshëm të Punës për Zhvillim Rural i Evropës Juglindore



Aleksandra Todorovska, si përfaqësues i Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë ka marrë pjesë në mbledhjen e 28 të Kuvendit të Grupit të Përherëshëm të Punës

për Zhvillim Rural i Evropës Juglindore, që u mbajt në Gmunden, Austri, gjatë periudhës prej 4 deri më 8 dhjetor.

Në kuadër të programit ishin organizuar edhe udhëtime në teren, në të cilat

vizitorët kishin mundësi të mbledhin përvoja nga praktikë e mira të realizuara nga rrethina e Gmunden. Gjatë

mbledhjes ishin prezantuar konkluzionet nga mbledhja e shtatë vjetore e Ministrive për Bujqësi të Evropës Juglindore, plani veprimi i Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural, programet për zhvillim rural të Austrisë si dhe ishin hapur diskutime lidhur me bashkëpunimi e Grupit të Përherëshëm të Punës me organizata të shumta ndërkombëtare.

Anëtarët e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural, mes të cilëve ishin përfaqësuesit e rrjeteve për zhvillim rural nga R. e Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës, shfrytëzuan këtë mundësi për të realizuar takime në të cilat u diskutuan aktivitetet e ardhshme të Rrjetit.





U publikua libri nga PREPARE



Libri, “Fryma e komunitetit fiton” - Në ç’mënyrë shoqëria qytetare e mbështet Evropën rurale, paraqet në konfirmim për aktivitetin shumëvjeçar të Organizatës Evropiane të Rrjeteve qytetare, PREPARE - Partneritet për Evropë Rurale, që prej themelimit të saj në vitin 2000. Ky libër, që përbëhet nga një

numër i deklaratave të individëve të përfshirë në zhvillimin rural dhe sektorin qytetar në Evropë, njëherë e promovuar nga Komisari i Bashkimit Evropian për bujqësi dhe zhvillim rural Dajçan Çolosh, bindshëm tregon që qytetarët dhe organizatat qytetare janë të interesuar shumë që të kontribuojnë për proceset zhvillimore në mjediset rurale.

PREPARE - Partneritet për Evropë Rurale ka bërë shumë gjatë 13 vitet e fundit për të stimuluar përforsimin e shoqërisë qytetare në vendet anëtare të BE-së si dhe shtetet para aderimit nga Evropa Qendrore, Lindore dhe Juglindore, duke i inkurajuar njerëzit nga mjediset rurale të marrim pjesë aktive, në partneritet, për zhvillimin socio-ekonomik

të Bashkimit Evropian. Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë është anëtare e plotë e PREPARE që prej vitit 2012 dhe merr pjesë me një deklaratë në këtë libër dhe i prezanton shqyrtimet e saja për zhvillim të demokracisë, sundimit, partneritetit dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor në mjediset rurale.



Pjesëmarrje të Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikë së Maqedonisë në Parlamentin Rural Evropian të parë

Më 13 nëntor 2013 në Bruksel ishte organizuar Parlamenti Rural Evropian i parë, PRE-ja. Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Komisionit Ekonomik dhe Social Evropian, Parlamenti ishte mbajtur në hapësirat e tyre në Bruksel dhe ishte një mbledhje në vetë qendrën e fuqisë politike evropiane. Në eventin morën pjesë më tepër se 150 përfaqësues të 70 organizatave rurale, mes të cilëve ishte edhe përfaqësuesi i Rrjetit për Zhvillim Rural i RM-së, me qëllim të vendosën problemet me të cilat përballohen komunitetet rurale në agjendën e BE-së dhe të ndikojnë mbi politikën që i krijojnë jetën e tyre.

Parlamenti Rural Evropian është një koncept, ide, event, vizioni i asociacioneve rurale dhe bashkësive lokale. Ai paraqet një forum për shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes lëvizjeve dhe rrjeteve kombëtare rurale. Qëllimi i PRE-së është të zbatojë një zë të përbashkët për përf forcimin e lëvizjes rurale në Evropë. Parlamen-



ti Rural Evropian do të krijojë një deklaratë të përbashkët e cila do të ndikojë mbi politikën rurale evropiane, do të përmirësojë dialogun e vendimmarrësve në nivelin lokal, do të mundësojë shkëmbim të përvojave të një zhvillimi të suksesshëm lokal dhe do të gjejë formë në të cilën PRE-ja do të vazhdojë të jetojë nëpër Evropë.

Lëvizjet rurale që kanë marrë pjesë në iniciativën arrijnë në konkluzionin që kanë shumë probleme të përbashkëta dhe interesa siç janë cilësia e shkollave në mjediset rurale, qasja në institucionet shëndetësore dhe shërbime tjera themelore si dhe mundësia për të ndikuar mbi politikën e BE-së.

Parlamenti Rural Evropian ka krijuar një përzierje të duhur të mendimeve nga nivelet e larta dhe më të ulëta, në kombinim me praktikën. Procesi do të vazhdojë edhe pas eventit, në formë të detyrave dhe vendimeve që do të shprehen nga grupet e punës, të cilat do të njoftojnë më tutje për progresin e arritur.